



VENDIM

Nr. 97 Datë 16.07.2012

PËR

**KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE PRODHUESE NGA HEC-ET
“DARSI 1”, “DARSI 2” DHE “DARSI 3” TË SHOQËRISE “HENZ
ENERGY”, SI BURIME TË RINOVUESHME ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “l”, 9 dhe 39 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 7 dhe 9 pikat 1 dhe 2 gërma “a” të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 16.07.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Henz Energy” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për kualifikimin e impiantit prodhues për Hec-et “Darsi 1”, “Darsi 2”, “Darsi 3” si Burime të Rinovueshme energjie,

Konstatohet se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Henz Energy” sh.p.k, është konform Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**
Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.
Ky dokumentacion është dhënë i sakte dhe i plote.
- **Neni 7, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**
Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.
Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.
- **Neni 7 pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”**
Përshkrimi i centralit...
Ky dokumentacion është dhënë i sakte dhe i plote.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI :

1. Të kualifikojë impiantet prodhuese nga HEC-et “Darsi 1”, “Darsi 2” dhe “Darsi 3” të shoqërisë “Henz Energy” sh.p.k, si Burime të Rinovueshme energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI